



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur, KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 92-të, të mbajtur më 11.09.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-2231/1 të datës 17.06.2020, e formuar pas kërkesës së dorëzuar për ndryshimin e programit të specialitetit gjatë specializimit në ///në Shkup, NDËRPRITET

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, dhe aplikimi do të dorëzohet për veprime të mëtejshme kompetente në Ministrinë e Shëndetësisë.

Lënda me numër 12-2231/1 datë 17.06.2020 të mbyllet dhe arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 17 qershor 2020, një parashtrues i njohur ka dorëzuar denoncim për zyrtarin për ndryshimin e programit të specialitetit gjatë specializimit në /// në Shkup dhe është konstatuar rasti me numër 12-2231/1 të datës 17 qershor të vitit 2020.

Pretendimet në denoncim i referohen dyshimeve se klinika e specifikuar për një periudhë të gjatë kohore ka lejuar disa praktikantë të ndryshojnë programin e specialitetit gjatë specializimit të tyre. Në këtë mënyrë u mohua mundësia e regjistrimeve të reja për specializim sepse numri i parashikuar i kursantëve u plotësua nga ndryshimi i mëparshëm i programit në kursantë nga programet e tjera.

Me qëllim të verifikimit të pretendimeve dhe konstatimit të gjendjes faktike në rastin e raportuar, KSHPK-ja ka dorëzuar disa kërkesa për mbledhje të informacionit në Ministrinë e Shëndetësisë, nga ku nuk ka marrë asnjë informacion lidhur me pretendimet nga raporti.

Gjatë analizës së informacionit të disponueshëm publik, KSHPK-ja erdhi në dijeni se kjo praktikë është zbatuar për një periudhë të gjatë kohore dhe është nën juridiksionin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Nga sa u tha më lart, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme, dhe kërkesa do t'i dërgohet Ministrisë së Shëndetësisë për veprime të mëtutjeshme kompetente dhe vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar :

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: K.Z

Miratoi: N.B anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËROР
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Nënkryetar,
Sofka Pejovska Dojçinovska
